



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr.651, datë 14.9.2011

PËR

LICENCIMIN E AKADEMISË PROFESIONALE TË BIZNESIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, e 43, 44, 44/1 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Licencimin e Akademisë Profesionale të Biznesit, e cila ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës.
2. Akademia Profesionale e Biznesit organizohet në dy fakultete:
 - a) Fakulteti i Ekonomisë;
 - b) Fakulteti i Drejtësisë.
3. Format e studimeve në Akademinë Profesionale të Biznesit janë studime me kohë të plotë dhe studime me kohë të pjeshme.
4. Fakulteti i Ekonomisë ofron:
 - a) Programet e studimit të ciklit të parë, në përfundim të të cilit merret diploma "Bachelor" në "Ekonomi" në tri profile:

- i. "Banka dhe institucione financiare";
- ii. "Administrim biznesi";
- iii. "Financë kontabilitet".

b) Programet e studimit të ciklit të dytë, në përfundim të të cilit merret diploma "Master profesional" në:

- i. "Kontabilitet financë";
- ii. "Menaxhim biznesi".

5. Fakulteti i Drejtësisë ofron:

a) Programet e studimit të ciklit të parë, në përfundim të të cilit merret diploma "Bachelor" në:

- i. "Drejtësi";
- ii. "E drejtë biznesi".

b) Programet e studimit të ciklit të dytë, në përfundim të të cilit merret diploma "Master i shkencave" në:

- i. "E drejtë penale";
- ii. "E drejtë civile dhe tregtare".

6. Akademia Profesionale e Biznesit, Tiranë, fillon veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga ministri i Arsimit dhe Shkencës.


7. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Akademia Profesionale e Biznesit, Tiranë, duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore në fuqi.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Akademia Profesionale e Biznesit, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

MYQEREM TAFAJ

